



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Pedagogjisë**  
**Me datë: 23.09.2021**

Vendimet për TEMAT MASTER					
#	Kandidati	Tema e punimit	Komisioni		Vendimi
1	Donjeta Shabani Hasani	Bashkëpunimi udhëheqës - nxënës në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollat fillore të komunës së Podujevës	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Ardita Devolli	
			Anetar/e	Sylejman Berisha	
2	Alberie Sejdiu	Ndryshimet e bindjeve të mësimdhënësve nën thjerrën e zhvillimit të tyre profesional rreth kurrikulës	Kryetar/e	Majlinda Gjellaj	Miratohet
			Mentor/e	Blerim Saqipi	
			Anetar/e	Naser Zabeli	
3	Gentiana Zeqiraj	Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze në nivelin parafillor	Kryetar/e	Majlinda Gjellaj	Miratohet
			Mentor/e	Blerim Saqipi	
			Anetar/e	Naser Pajaziti	
4	Donjeta Nrecaj	Vështirësitë në menaxhimin e klasës në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Blerim Saqipi	
			Anetar/e	Teuta Danuza	
6	Doruntina Hajdari	Faktorët që ndikojnë në pranueshmërinë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë fillore	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Ardita Devolli	
7	Teuta Gashi	Qëndrimet dhe praktikat e edukatoreve në lidhje me zhvillimin socio-emocional të fëmijët e moshës parashkollore	Kryetar/e	Arlinda Beka	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Myrvete Dreshaj	
8	Dafina Latifi	Perceptimet e mësimdhënësve lidhur me rëndësinë e përgatitjes së tyre për kompetencat pedagogjike	Kryetar/e	Hatixhe Ismajli	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Arlinda Beka	
9	Ermira Kajtazi	Roli i udhëheqësit në adaptimin e mësimdhënësve fillestarë në procesin e mësimdhënies në shkollat fillore	Kryetar/e	Naser Zabeli	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Blerim Saqipi	
10	Rilinda Dreshaj	Sfidat e mësimdhënësve gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve lëndore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta	Kryetar/e	Vjollca Ahmedi	Miratohet
			Mentor/e	Majlinda Gjellaj	
			Anetar/e	Haki Xhakli	
11	Leodita Koshi	Aplikimi i teknikave të mësimdhënies në përmirësimin e rezultateve të të nxënësve në lëndën e matematikës	Kryetar/e	Valbona Berisha	Miratohet
			Mentor/e	Hatixhe Ismajli	
			Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
12	Abetare Banushi	Analiza e aparaturës didaktike në tekstet mësimore sipas fushave kurrikulare në klasën e parë	Kryetar/e		Miratohet
			Mentor/e	Hatixhe Ismajli	
			Anetar/e		
13	Xheraldina Hashani	Efektet e strategjive të mësimdhënies në zhvillimin e kompetencës së të menduarit	Kryetar/e	Blerim Saqipi	Miratohet
			Mentor/e	Hatixhe Ismajli	
			Anetar/e	Arlinda Beka	
14	Fatjeta Ahmeti	Perceptimet e mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të studentëve të FE-së për mentorimin gjatë praktikave mësimore	Kryetar/e	Vlora Sylaj	Miratohet
			Mentor/e	Hatixhe Ismajli	
			Anetar/e	Vjollca Ahmedi	
15	Jehona Dautaj	Ndikimi i detyrave të shtëpisë në lëndën e gjuhës shqipe në klasën e parë	Kryetar/e	Naser Pajaziti	Miratohet
			Mentor/e	Hatixhe Ismajli	
			Anetar/e	Adhurim Rasimi	
16	Mimoza Hoti Kolukaj	Perceptimet e pjesëtarëve të komuniteteve të shkollës për komunikimin e drejtorit në institucionet e nivelit të SHFMU	Kryetar/e	Ethem Ceku	Miratohet
			Mentor/e	Demë Hoti	
			Anetar/e	Januz Dervodeli	

## **DONJETË SHABANI-HASANI**

**Tema:** “Bashkëpunimi udhëheqës - nxënës në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollat fillore të komunës së Podujevës”

### **Komisioni:**

1. Dr.sc. Ardita Devolli, prof.ass. – mentore
2. Dr.sc. Blerim Saqipi, prof.ass. – kryetar
3. Dr.sc. Sylejman Berisha, prof.ass. – anëtar

### **ABSTRAKTI**

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shkolla është një kusht elementar për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të arsimit. Dhuna në shkolla është një dukuri mjaft shqetësuese, sidomos në vitet e fundit ku mendohet se dhuna është bërë më e përhapur në sistemin e edukimit.

Dhuna në shkolla reflekton çka është duke ndodhur në një shoqëri si tërësi. Andaj, qëllim kryesor është të shqyrtohet bashkëpunimi i udhëheqësit në krijimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit në shkollë, si dhe krijimin e bashkëpunimit shkollë-komunitet.

Analiza e gjendjes aktuale është realizuar përmes hulumtimit në formë të pyetësorëve me udhëheqës, nxënës si dhe me psikologët e shkollave. Respondentët e hulumtimit janë 4 drejtorë, 4 psikologë si dhe 333 nxënës të klasave të pesta. Pyetësorët janë realizuar në disa shkolla të Komunës së Podujevës “Shaban Shala”, “Naim Frashëri”, “Ibrahim Rugova”, si dhe në shkollën “Xheladin Rekalii”. Të gjitha të dhënat e grumbulluara përmes pyetësorëve janë analizuar me anë të paketës statistikore për shkencat sociale SPSS. Hulumtimi ka të dhëna sasiore.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi është: Si ndikon bashkëpunimi udhëheqës-nxënës në krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë?

Nga analiza e të dhënave të këtij hulumtimi është treguar se drejtorët e shkollave janë shumë bashkëpunues me nxënësit dhe kjo ndikon edhe në suksesin dhe në sigurinë e tyre në shkollë. Po ashtu, udhëheqësit e shkollave që janë anketuar për këtë punim mendojnë që fëmijët nuk janë viktima të dhunës në shkollë, pasi që bashkëpunimi mes tyre dhe prindërve ndikon në sigurinë e nxënësve dhe krijon një ambient më të sigurt shkollor. Nga pyetësi që është zhvilluar me nxënësit është konkluduar se dhuna më shumë ndodh në rrugë pranë shkollës dhe në hyrje të shkollës, dhe se dhuna më shumë është e pranishme te gjinia mashkullore. Hulumtimi tregon se mungojnë aktivitetet nga ana e shkollave për parandalimin e akteve të dhunshme, kështu që shkollat duhet të organizojnë më shumë aktivitete në këtë drejtim.

**Fjalët kyçe:** *Bashkëpunimi, dhuna, mjedisi, nxënësit, udhëheqësi.*

---

## **ALBERIE SEJDIU**

**Titulli:** “Ndryshimet e bindjeve të mësimdhënësve nën thjerrën e zhvillimit të tyre profesional rreth kurrikulës”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Blerim Saqipi, mentor
2. Prof. Majlinda Gjelaç, kryetare
3. Prof. Naser Zabeli, anëtar

### **ABSTRAKT**

Ky hulumtim diskuton ndryshimet e bindjeve të mësimdhënësve nën thjerrën e zhvillimit të tyre profesional rreth kurrikulës. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë këndvështrimin e mësimdhënësve lidhur me atë se si ndikon zbatimi i kurrikulës në ndryshimin e bindjeve rreth zhvillimit të tyre profesional. Ky proces është hulumtuar nga momenti kur mësimdhënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve (ZhPM) e deri tek momenti i ndryshimit të bindjeve, si rezultat i ndikimit të zbatimit të kurrikulës në praktikën e tyre të mësimdhënies në klasë. Hulumtimi ndjekë një qasje kualitative, duke marrë si rast studimor mësimdhënësit e klasave 1-3 të shkollave fillore publike të komunës së Prishtinës. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur intervistat si dhe fokus grupi, të cilat na ndihmuan për të kuptuar bindjet e mësimdhënësve lidhur me ndryshimet e praktikave në mësimdhënie. Nga analiza e të dhënave kuptojmë si kanë ndikuar aktivitete e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në ndryshimin e bindjeve të tyre, lidhur me praktikën mësimore, veçanërisht në hartimin e planprogramit, në vlerësim në metodologji të punës dhe aktivitete si dhe në integrimin dhe koherencën e lëndëve. Ky hulumtim vë në pah faktin se mësimdhënësit mendojnë që reforma e re kurrikulare ka qenë e nevojshme, porse ata e perceptojmë zbatimin e kurrikulës së re si mjaft sfiduese dhe vështirë të zbatueshme në praktikë. Një prej gjetjeve të tjera të rëndësishme të këtij hulumtimi është se mësimdhënësit kanë qenë të papërgatitur për sfidat që ka sjellur zbatimi i kurrikulës së re. Rrjedhimisht, rekomandimi kryesor i këtij hulumtimi është, që është e rëndësishme qenësore sesi transmetohen tek mësimdhënësit reformat në fushën e arsimit – siç është kurrikula e re.

**Fjalët kyçe:** *bindje, mësimdhënës, ndryshim, kurrikulë, zhvillim profesional*

---

## **GENTIANA ZEQR AJ**

**Titulli:** “Qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien e gjuhës angleze në nivelin parafillor”

### **Komisioni:**

1. Prof. Blerim Saqipi, mentor
2. Prof. Majlinda Gjellaj, kryetare
3. Prof. Naser Pajaziti, anëtar

### **ABSTRAKT**

Për të qenë në gjendje të prezantojnë në mënyrë adekuate lëndën e kërkuar në klasë, mësuesit duhet të jenë në gjendje të mbajnë në mend shumë aspekte në lidhje me nxënësit, të tilla si: moshën, materialin, interesin, nivelin, inteligjencën, kohën dhe kushtet fizike në klasë etj. Duke pasur parasysh këtë, në këtë studim janë hulumtuar qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me aspektet e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës angleze tek niveli parafillor ku fillimisht tregohet se si qëndron niveli i përgatitjes profesionale të mësimdhënësve pastaj kemi trajtuar rëndësinë që ka mësimi i gjuhës angleze tek nxënësat e rinj, a ka zbatueshmëri të kurrikulës, cilat janë metodat dhe materialet me të pershtatshme për këtë nivel fëmijësh si dhe cilat janë sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit gjatë punës me ta.

Hulumtimi në fjalë është fokusuar në qytetin e Prishtinës dhe Istogut, në shkollën nga qyteti dhe fshatrat, ku respondentët të këtij hulumtimi ishin gjithësej 74 mësimdhënës të gjuhës angleze. Instrumenti i përdorur për këtë hulumtim është përpiluar duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat hulumtuese, i cili është i ndarë në dy pjesë, ku pjesa e parë përfshin të dhënat demografike, ndërsa pjesa e dytë përfshin 33 pyetjet të hartuara sipas shkallës Likert.

Në këtë hulumtim u supozua se “Mësimi i gjuhës angleze në fëmijërinë e hershme ndikon pozitivisht në zhvillimin e shkathtësive gjuhësore të nxënësve”, hipotezë e cila vërtetohet me anë të analizës së frekuencave; pastaj u supozua se “Mësimdhënësit janë profesionalisht të aftësuar për zbatimin e kurrikulës së gjuhës angleze tek niveli parafillor” hipotezë e cila refuzohet nga ky hulumtim pas analizës dhe interpretimit të të dhënave dhe si rrjedhojë jepen edhe disa rekomandime që mund të përmirësojnë gjendjen në të ardhmen.

**Fjalët kyqe:** Klasa përgatitore, gjuhë angleze, mësimdhënënie, mësimnxënie, kurrikulë, sfida.

---

## DONJETA NRECAJ

**Titulli:** “Vështirësitë në menaxhimin e klasës në shkollat e mesme të ulëta”

**Komisioni:**

1. Prof. Ass. Blerim Saqipi, mentor
2. Prof. Naser Zabeli, kryetar
3. Prof. Teuta Danuza, anëtare

### ABSTRAKT

Në mënyrë që procesi mësimor të ketë mbarëvajtjen e duhur dhe rezultate sa më të mira, janë shumë me rëndësi edhe aspektet menaxhuese të klasës, prandaj ky është fokusi i këtij hulumtimi. Përmes trajtimit teorik të temës i kemi shtjelluar kriteret dhe atributet themelore të menaxhimit të klasës që çdo mësimitdhënës duhet t'i zotërojë dhe t'i zbatojë gjatë punës me nxënës. Gjithashtu, është synuar që të bëhet një ndërlidhje në mes të këtyre aspekteve teorike dhe praktikës aktuale të shkollave e Kosovës (konkretisht në shkollat ku është bërë hulumtimi empirik) dhe të sigurojmë të dhëna relevante dhe sa më reale të asaj se si e menaxhojnë klasën mësimitdhënësit tanë, cilat janë vështirësitë me të cilat përballen gjatë menaxhimit si dhe çfarë strategji, praktika përdorin që t'i tejkalojnë ato vështirësi. Poashtu nga nxënësit është synuar të kuptohet se cilat praktika të menaxhimit të klasës të cilat i përdorin mësimitdhënësit e tyre i mirëpresin më shumë ata dhe kështu të shohim a ka ndërlidhje mes përgjigjeve të mësimitdhënësve dhe atyre të nxënësve.

Hulumtimi është realizuar në 6 shkolla të Ferizajit (nga të cilat 3 shkolla të qendrës, 3 shkolla të fshatërave), me respodentë 10 mësues të klasave VI-IX dhe 200 nxënës të po atyre shkollave.

Të dhënat e hulumtimit janë mbledhur përmes (instrumenteve) intervistave me mësimitdhënës dhe pyetësorëve me nxënës. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se mësimitdhënësit e kuptojnë drejt termin “menaxhim i klasës” si dhe gjatë mësimitdhënies ata shpesh përballen me disa vështirësi të menaxhimit të klasës. Gjithashtu hulumtimi na vë në pah praktikën, metodat, strategjitë që përdorin këta mësimitdhënës për t'i tejkalar këto vështirësi. Hulumtimi gjithashtu tregon se mungojnë trajnime dhe përgatitje adekuate që ndihmojnë mësimitdhënësit në këtë aspekt.

**Fjalët kyçe:** *Klasë, menaxhim, mësimitdhënës, nxënës, proces mësimor, vështirësi*

---

## **MIMOZA HOTI-KOLUKAJ**

**Tema:** “Perceptimet e pjesëtarëve të komuniteteve të shkollës për komunikimin e drejtorit në institucionet e nivelit të SHFMU”

### **Komisioni:**

1. Prof. Demë Hoti, mentor
2. Prof. Ethem Ceku, kryetar
3. Prof. Januz Dervodeli, anëtar

### **ABSTRAKT**

Komunikimi në mënyrë efektive është një dimension kryesor i udhëheqjes së shkollave. Menaxhimi i shkollës pritet të jetë kompetencë e komunikimit të drejtorit me pjesëtarët e komuniteteve dhe në të njëjtën kohë të reflektoj ndikimin e saj në udhëheqje efikase dhe ngritjen e performancës së shkollës. Në shkollë, komunikimi duhet të ndodh në çdo kohë, në të gjitha drejtimet dhe në shumë mënyra. Pra, komunikimi i drejtorit me pjesëtarët e komuniteteve duhet të përfshij në mënyrë të veçantë veprimet me të cilën shkëmbehet informacioni, zhvillohet ideja, propozohet vizioni dhe misioni i shkollës, si dhe diskutohet për përmirësimin e arritjeve të të nxënit. Sidoqoftë, qëllimi i këtij hulumtimi është të reflektoj perceptimet e pjesëtarëve të komuniteteve të shkollës në lidhje me komunikimin e drejtorit dhe të pasqyroj se në çfarë mase ekziston kjo marrëdhënie. Po ashtu, qëllimi tjetër është të vlerësoj ndikimin e komunikimit të ndërsjellë në mes të drejtorit në institucionet e nivelit të SHFMU me pjesëtarët e komuniteteve për një udhëheqje efikase dhe shkollë cilësore. Prandaj, ky hulumtim përqendrohet kryesisht në problemin rreth nivelit të komunikimit të drejtorëve me pjesëtarët e komuniteteve të shkollës. Rëndësia e problemit të zgjedhur është se hulumtimi ndihmon në zgjerimin e fushës së kërkimit për secilën prej subjekteve të shkollës dhe nivelit të komunikimit të drejtorit. Për metodologji të këtij hulumtimi është përdorur një model studimi të metodave të përziera, e cila përfshin analizën e të dhënave sasiore dhe cilësore. Mostra e zgjedhur përfaqësohet me rreth 520 pjesëmarrës nga komunitetet e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit. Ndërkaq, për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore shërbehet me anë të pyetësorëve dhe intervistave. Të dhënat sasiore të mbledhura nga pyetësorët janë analizuar përmes programit SPSS. Kurse, të dhënat cilësore janë përshkruar përmes interpretimit narrativ. Rezultatet e hulumtimit po tregojnë se perceptimet e pjesëtarëve të komunitetit shprehin mendim pozitiv në lidhje me komunikimin e drejtorit të shkollës me këta pjesëtarë. Po ashtu, rezultatet theksojnë se bashkëpunimi me komunitetin e brendshëm dhe të jashtëm të shkollës po ndikon në menaxhimin dhe udhëheqjen efektive të shkollës.

**Fjalët kyçe:** *Drejtor, komunikim, komunitet, perceptim dhe shkollë.*

---

## **DORUNTINA HAJDARI**

**Tema:** “Faktorët që ndikojnë në pranueshmërinë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollë fillore”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Majlinda Gjelij- mentore
2. Prof. Asoc. Naser Zabeli- kryetar
3. Prof. Ass. Ardita Devolli- anetare

### **ABSTRAKTI**

Qëllimi i këtij hulumtimi është që të identifikohen faktorët të cilët ndikojnë në pranueshmërinë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta nga bashkëmoshatarët e tyre.

Si responentë të hulumtimit ishin 145 persona, ku prej tyre 49 ishin nxënës, 48 mësime dhënë dhe 48 prindër të po atyre nxënësve.

Si instrument për këtë hulumtim është përdorur pyetësi i përpiluar dhe i ndarë në pyetje për nxënësit, prindërit dhe për mësime dhënë. Pyetësi përmban pyetje demografike, rreth gjithëpërfshirjes dhe pranueshmërisë sociale të fëmijëve me NV. Të dhënat janë analizuar me Pakon Statistike të Shkencave Sociale – SPSS 21, dhe janë përdorur analiza e besueshmërisë, analiza e frekuencave, analiza korelacionare dhe T-tesi.

Për këtë hulumtim janë ngritur tri hipoteza “Egziston ndërlidhje signifikante pozitive në mes të faktorit të ulët ekonomik dhe pranueshmërisë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta”; “Egziston ndërlidhje signifikante pozitive në mes të faktorit kulturor dhe pranueshmërisë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta”; “Egziston ndërlidhje signifikante pozitive në mes të klimës së klasës dhe pranueshmërisë sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta”, të cilat janë vërtetuar me anë të analizës korelacionare.

**Fjalët kyçe:** *socializim, bashkëmoshatarë, fëmijë, nevojë e veçantë.*

---

## **TEUTA GASHI**

**Tema:** “Qëndrimet dhe praktikat e edukatoreve në lidhje me zhvillimin socio-emocional të fëmijët e moshës parashkollore”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Majlinda Gjellaj- mentore
2. Prof. Ass. Arlinda Beka- kryetare
3. Prof. Asoc. Myrvete Dreshaj - anëtare

### **ABSTRAKTI**

Zhvillimi socio- emocional përbën një fushë mjaft të rëndësishme në zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme. Studimet tregojnë se kjo fushë ndërlidhet edhe me arritjet akademike në të ardhmen e fëmijës. Duke ditur se zhvillimi emocional është një proces mjaft i rëndësishëm të fëmijët, nëpërmjet këtij hulumtimi shohim se sa i kushtojnë rëndësi zhvillimit emocional të fëmijëve edukatorët në moshën parashkollore. Sot, mendohet se, aftësitë sociale dhe inteligjenca emocionale, përbëjnë çelësin e zhvillimit të përgjithshëm të individit. Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte që të marrim një pasqyrë të qartë lidhur me qëndrimet e edukatoreve në lidhje me rëndësinë që ka fusha e zhvillimit social-emocional gjatë moshë parashkollore. Si e shohin edukatorët këtë fushë të zhvillimit në raport me zhvillimin kognitiv apo psiko-motorik? Çfarë bëjnë ato, që ta përkrahin këtë fushë zhvillimore të grupmoshat e ndryshme parashkollore? Cilat janë problemet me të cilat ato ballafaqohen më së shumti? Këto dhe shumë çështje të tjera, rreth zhvillimit social dhe emocional të fëmijëve të kësaj moshe do ne i trajtojmë në këtë hulumtim.

Në këtë hulumtim kemi përdorur metodën sasiore dhe cilësore, janë intervistuar 10 edukatore të cilat punojnë në rajone të ndryshme të Kosovës duke përfshirë, zonat rurale dhe urbane. Supozohet se në Kosovë por edhe në vende të tjera të rajonit, edukimi parashkollor po shkon drejt shkollarizmit dhe në fokus kryesor të kësaj hallke të sistemit arsimor është fusha e zhvillimit kognitiv ose intelektual dhe në masë të madhe po lihet anash zhvillimi socio-emocional. Dihet fare mirë, se fëmijët e vegjël, mësojnë më së miri nëpërmjet lojës, duke ndërvepruar me bashkëmoshatar, duke zgjidhur konflikte bashkë me ta, duke ndarë lodrat, duke u gëzuar e hidhëruar, duke lëvizur e ndërvepruar me ambientin dhe kjo, në mënyrë indirekte qon drejt zhvillimit të të menduarit apo aspekteve të tjera të zhvillimit psiko-motorike.

---



## **DAFINA LATIFI**

**Tema:** “Përceptimet e mësimdhënësve lidhur me rëndësinë e përgatitjes së tyre për kompetencat pedagogjike”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Majlinda Gjellaj- mentore
2. Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli - kryetare
3. Prof. Ass. Arlinda Beka- anëtare

### **ABSTRAKTI**

Proceset që ndodhin në kontekstin shkollor dhe në mjediset arsimore, në përgjithësi, janë thelbësisht relacionale. Këto marrëdhënie vendosen në nivele të ndryshme, për shembull, midis studentëve dhe midis mësuesve, si dhe midis studentëve dhe mësuesve. Marrëdhënia midis studentëve dhe mësuesve ka qenë një temë kërkimore në mbarë botën me interes për shumë vite, dhe një sasi e madhe studimesh kanë konfirmuar rolin e saj si një parashikues i rezultateve akademike të studentëve dhe përshtatjes sociale. Në këtë punim, ne u përqendruam në analizimin e përceptimeve të mësimdhënësve mbi përgatitjen pedagogjike të tyre gjatë studimeve dhe në shërbim.

Metodologjia e këtij studimi është e tipit kuantitativ. Grumbullimi i të dhënave është i natyrës primare. Instrumenti matës i këtij studimi është pyetësori i cili ishte plotësisht anonim. Pyetësori përbëhet nga dy seksione: në seksionin e parë kemi të dhënat e përgjithshme demografike kurse seksioni i dytë përbëhet nga pyetje specifike lidhur me temën e studimit.

Mostra e studimit është 195 mësimdhënës të shkollave të niveleve të ndryshme.

Mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim e vlerësuan lartë rolin e përgatitjes profesionale të mësimdhënësve e në veçanti përgatitjes së tyre sa i përket kompetencave pedagogjike me qëllim të edukimit sa më cilësor të nxënësit/studentit.

**Fjalet kyçe:** *Mësimdhënës, nxënës, ndikim, mësimdhënie, përgatitje.*

---

## **ERMIRA KAJTAZI**

**Tema:** “Roli i udhëheqësit në adaptimin e mësimdhënësve fillestarë në procesin e mësimdhënies në shkollat fillore”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Majlinda Gjelij- mentore
2. Prof. Ass. Naser Zabeli- kryetar
3. Prof. Ass. Blerim Saqipi- anëtar

### **ABSTRAKTI**

Hulumtimi “Roli i udhëheqësit në adaptimin e mësimdhënësve fillestarë në procesin e mësimdhënies në shkollat fillore” është studim me qasje mikse. Qëllimi i këtij hulumtimi është të vë në pah adaptimin e mësimdhënësve në procesin e mësimdhënies në vitet e para të punës, të identifikojë sfidat që ata kanë dhe formën më të shpeshtë të mbështetjes nga ana e udhëheqësit në mënyrë të adaptimit sa më të lehtë.

Hulumtimi është miks, kemi të bëjmë me të dhëna sasiore dhe cilësore. Të dhënat cilësore janë mbledhur përmes intervistave me drejtorë, ndërsa të dhënat sasiore përmes pyetësorit me mësimdhënës. Popullata e këtij hulumtimi përfshinë të gjithë mësimdhënësit fillestarë të shkollave fillore të Komunës së Vushtrrisë. Të dhënat statistikore për numrin e shkollave dhe mësimdhënësve u huazuan nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtri. Nga shkollat me mësimdhënës fillestarë janë zgjedhur 12 shkolla me mostër jo të rastësishme, më konkretisht me mostrën sipas kuotave (quota sampling) duke u bazuar në numrin më të madh të mësimdhënësve fillestar të pranuar. Nga ta janë zgjedhur 12 udhëheqës dhe 30 mësimdhënës. Të dhënat janë analizuar përmes paketës statistikore SPSS, kryesisht janë bërë analiza përshkruese (frekuenca, përqindje, mesatare dhe devijim standard) dhe analiza inferenciale (t-test) dhe për analiza cilësore janë bërë edhe analiza tematike. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë për sfidat dhe aktivitete që drejtori ndërmerr për t'i përkrahur mësimdhënësit fillestarë për të tejkaluar sfidat, që kryesisht kanë të bëjnë me menaxhimin e kohës dhe klasës, mbledhjet e prindërve dhe planifikimin pedagogjik. Nga rezultatet e marra mund të themi se ka pak mbështetje të drejtorit për mësimdhënësit fillestarë. Mësimdhënësit fillestarë me kalimin e dy viteve përvojë pune ndihen më të lirshëm, më të sigurtë dhe kanë më shumë besim në profesionalizmin e tyre.

---

## **RILINDA DRESHAJ**

**Tema:** “Sfidat e mësimdhënësve gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve lëndore në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta”

### **Komisioni:**

1. Prof. Ass. Majlinda Gjellaj- mentore
2. Prof. Ass. Vjollca Ahmedi- kryetare
3. Prof. Ass. Haki Xhakli- anëtar

### **Abstrakti**

Qëllimi i këtij hulumtimi është evidentimi i sfidave kryesore të mësimdhënësve në planifikimin dhe zbatimin e programeve lëndore në shkolla fillore dhe ato të mesme të ulëta.

Për ta realizuar këtë hulumtim do të përdoret metodologjia e metodave të përziera, paradigmë kjo e cila mundëson përgjigjen në pyetjen kryesore hulumtuese, se cilat janë sfidat nëpër të cilat kalojnë mësimdhënësit gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca? Studimi synon të gjej gjithashtu, nëse ka dallime signifikante midis vështirësive që kalojnë mësimdhënësit e shkollave fillore dhe atyre të mesme të ulëta, sa i përket planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës dhe cilat janë nevojat e tyre për t’i përkrahur në këtë drejtim.

Për mostër të këtij hulumtimi janë përzgjedhur 110 mësimdhënës të cilët japin mësim në shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta të Komunës së Istogut dhe që i përfshinë katër shkallë të kurrikulës, e që konkretisht janë përzgjedhur mësimdhënësit e klasave I-III (shkalla e parë dhe e dytë), VI-VIII (shkalla e tretë dhe e katër), prej tyre 100 mësimdhënës do të përgjigjen në pyetësorin e vetadministruar, ndërsa 10 prej tyre do i nënshtrohen intervistave të thella, me qëllim për të kuptuar më në thellësi problemin në fjalë. Të dhënat sasiore do të analizohen përmes programit kompjuterik statistikor (SPSS), ndërsa të dhënat cilësore do të paraqiten përmes analizës së përmbajtjes e cila përdoret në studime cilësore.

Rezultatet të cilat do të dalin nga ky projekt kërkimor do të ju shërbejnë institucioneve arsimore për ndryshime të reja dhe rishikim të dokumenteve ekzistuese me qëllim që mësimdhënësit ta kenë sa më të lehtë këtë proces, të krijohen kushte më të mira për planifikim dhe realizim të suksesshëm, të tregojnë rezultat dhe të jenë efektiv.

**Fjalët kyçe:** *kurrikula lëndore, planifikimi i procesit mësimor, sfidat e mësimdhënësve, përkrahja.*

---

## LEODITA KOSHI

**Tema:** “Aplikimi i teknikave të mësimdhënies në përmirësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e matematikës”

### Komisioni:

1. Prof. Valbona Berisha- kryetare
2. Prof. Vjollca Ahmedi- anetare
3. Prof. Hatixhe Ismajli-mentore

### ABSTRAKTI

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojmë efektet e aplikimit të teknikave të mësimdhënies në përmirësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e matematikës. Studimi synon gjithashtu të vë në pah qëndrimet e mësimdhënësve në lidhje me aplikimin e teknikave të mësimdhënies.

Për ta realizuar këtë hulumtim është përdorur metodologjia e metodave të përziera (sasiore dhe cilësore), paradigme kjo e cila mundëson përgjigjen në pyetjen kryesore hulumtuese: Çfarë efekti ka aplikimi i teknikave të mësimdhënies në përmirësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e matematikës, në shkallën e dytë të kurrikulës? Në mënyrë që hulumtimi të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe bindës është përdorur dizajni kuazi-eksperimental i cili shërben për të matur përmirësimin e rezultateve të të nxënit në lëndën e matematikës duke përdorur teknikat e mësimdhënies. Në këtë hulumtim kanë marrur pjesë 52 nxënës (dy paralele) të klasëve të katërta të shkollës fillore “Mustafa Bakija” në Gjakovë dhe 9 mësimdhënës që kanë klasët të cilat i takojnë shkollës së dytë të kurrikulës. Instrumentet që janë përdorur për këtë hulumtim janë paratesti dhe pastesti si dhe intervista gjysmë e strukturuar. Testet janë zhvilluar në dy klasët që janë pjesë e hulumtimit, ku njëra klasë paraqet grupin kontrollues ndërsa klasa tjetër grupin eksperimental. Krahasimi i rezultateve të dy testeve të realizuara në të dyja grupet, ka mundësuar thellimin e njohurive tona rreth ndikimit të teknikave të mësimdhënies te grupi eksperimental. Të dhënat sasiore janë analizuar në programin SPSS, ndërsa rezultatet e tyre janë paraqitur me anë të poligonit të frekuencës, ndërsa të dhënat cilësore u analizuan përmes qasjes së analizës tematike. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se aplikimi i teknikave të mësimdhënies ndikon konsiderueshëm në ngritjen e rezultateve të të nxënit të nxënësve në matematikë. Poashtu, dëshmojmë ndikimin e saj në motivimin e nxënësve për mësim dhe rritjes së frymës bashkëpunuese në mes nxënësve. Analiza tematike ka pasqyruar këndvështrime të ndryshme në lidhje me qëndrimin e mësimdhënësve për aplikimin e teknikave, por që kanë qenë të përafërta duke përkrahur inkuadrimin e tyre dhe përdorimin në mënyrë efikase.

**Fjalët kyçe:** *teknikat e mësimdhënies, lënda e matematikës, nxënësit, shkalla e dytë e kurrikulës.*

---

## **ABETARE BANUSHI**

**Tema:** “Analiza e aparaturës didaktike në tekstet mësimore sipas fushave kurrikulare në klasën e parë”

### **Komisioni:**

1. Prof. Qazim Elshani-kryetar,
2. Prof. Vlora Sylaj- anetare,
3. Prof. Hatixhe Ismajli-mentore

### **ABSTRAKTI**

Teksti mësimor është mjeti mësimor që ka përdorimin më të gjerë në mesin e mjeteve shkollore dhe është i pazëvendësueshëm gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nga perspektiva e punës me nxënësin në qendër dhe e punës së bazuar në kompetenca, është e rëndësishme që burimet mësimore t'i motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë progresin e tyre. Kurrikula e re ka nxjerrë në pah nevojën për botimin e teksteve mësimore dhe përshtatjen e tyre me kërkesat që ajo i ka parashtruar sistemit të ri arsimor në vendin tonë. Zbatimi i kurrikulës ndër të tjera ka parashtruar nevojën e ndryshimit dhe botimit të teksteve mësimore të reja në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e saj, gjë të cilën nuk e kanë bërë tekstet mësimore që tashmë janë larguar nuk përdorimi. Qëllimi i këtij studimi është analizimi i aparaturës didaktike të teksteve mësimore sipas fushave të kurrikulës në klasën e parë. Për të realizuar këtë studim është përdorur metodologji e kombinuar (sasiore dhe cilësore) duke u bazuar në analizimin e teksteve mësimore si dhe mbledhjen e të dhënave në teren. Pyetja hulumtuese e këtij studimi është “Sa gjen zbatim aparatura didaktike në tekstet mësimore të klasës së parë sipas fushave kurrikulare ?” Në këtë studim janë analizuar tekstet bazë të klasës së parë sipas 7 fushave kurrikulare (secili tekst mësimor bazë në klasën e parë sipas fushave përkatëse) Gjuhët dhe komunikimi, Artet Matematika, Shkencat e natyrës, Shoqëria dhe mjedisi, Edukata fizike sporti dhe shëndeti dhe Jeta dhe puna. Janë anketuar 20 mësues nga 5 shkolla fillore të komunës së Lipjanit. Të dhënat janë mbledhur me anë të një pyetësori për mësimdhënës cili përbëhet nga 13 pyetje, të cilat kanë nxjerrë në pah rëndësinë e zbatimit të aparaturës didaktike në tekstet mësimore.

Nga analiza e të dhënave, ka rezultuar se aparatura didaktike (pra pyetjet, detyrat, shprehjet, fjalori, ilustrimet, biografite, komentet, udhëzimet ) zbatohen në tekstet mësimore pasi ato janë marrë parasysh nga autorët e teksteve gjatë këtij botimi të ri por që ndoshta përseri ka vend për përmirësime me rastin e ribotimit të tyre.

**Fjalët kyçe:** *tekstet mësimore, fushat e kurrikulës, mësimdhënës, nxënës, klasë e parë*

---

## XHERALDINA HASHANI

**Tema:** “Efektet e strategjive të mësimdhënies në zhvillimin e kompetencës së të menduarit”

### **Komisioni:**

1. Prof. Blerim Saqipi-kryetar,
2. Prof. Arlinda Beka-anetare,
3. Prof. Hatixhe Ismajli-mentore

### **ABSTRAKTI**

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtoj efektet e strategjive të mësimdhënies të cilat krijojnë mundësi për zhvillimin e kompetencës “nxënësi mendimtar” në shkallën e dytë të kurrikulës në Kosovë. Hulumtimi gjithashtu ka për qëllim të identifikoj qëndrimet e mësimdhënësve ndaj efekteve të strategjive të mësimdhënies në zhvillimin e kompetencës së të menduarit në lëndën e matematikës dhe të konstatohet niveli i zbatimit të strategjive të mësimdhënies në arritjen e kompetencës së të menduarit në lëndën e matematikës në shkallën e dytë të kurrikulës.

Hulumtimi është realizuar duke përdorur metodologjinë e metodave të përziera për t’ju përgjigjur pyetjes hulumtuese; Cilat janë efektet e strategjive të mësimdhënies për zhvillimin e kompetencës së të menduarit në shkallën e dytë të kurrikulës ? Hulumtimi është realizuar me 70 nxënës të klasave IV dhe V të SH.F.M.U “ Vëllëzërit Frashëri” Lipjan, të cilët kanë përfaqësuar grupin eksperimental dhe grupin kontrollues, ndërsa intervista është realizuar me 6 mësimdhënës të klasave III, IV dhe V. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur instrumentet, si; paratesti, pastesti dhe intervista gjysmë e strukturuar. Të dhënat sasiore janë analizuar përmes programit SPSS, ndërsa në EXCEL është ndërtuar poligoni i frekuencës, dhe të dhënat cilësore janë analizuar përmes qasjes së analizës tematike.

Të gjeturat e hulumtimit tregojnë se strategjitë e mësimdhënies në lëndën e matematikës kanë ndikim pozitiv në zhvillimin e kompetencës së të menduarit tek nxënësit e shkallës së dytë të kurrikulës. Rezultatet e paratestit dhe pastestit të grupit eksperimental dhe grupit kontrollues regjistrojnë një dallim signifikant  $p = 0.005$ . Analiza tematike me qëndrimet e mësimdhënësve tregon se të gjithë mësimdhënësit pohojnë për efektin pozitiv të strategjive të mësimdhënies në lëndën e matematikës për zhvillimin e kompetencës së të menduarit tek nxënësit e shkallës së dytë.

**Fjalët kyçe:** *kompetenca e të menduarit, lënda e matematikës, strategjitë e mësimdhënies, të menduarit kritik, të menduarit kreativ.*

---

## **FATJETA AHMETI**

**Tema:** “Perceptimet e mësimdhënësve të arsimit fillor dhe të studentëve të FE-së për mentorimin gjatë praktikave mësimore”

### **Komisioni:**

1. Prof. Vlora Sylaj- kryetare,
2. Prof. Vjollca Ahmedi- anetare,
3. Prof. Hatixhe Ismajli-mentore

### **ABSTRAKTI**

Mentorimi gjatë praktikave mësimore mbetet një ndër komponentët më të rëndësishëm për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Studentët e Fakultetit të Edukimit, me anë të praktikave mësimore që i mbajnë gjatë studimeve në nivelin Bachelor, kanë mundësi që të mentorohen nga mësimdhënës mentor dhe të zhvillojnë shkathtësi profesionale e pedagogjike.

Meqenëse pas studimeve mësimdhënësit fillestar nuk kanë mësimdhënës mentor, i cili i udhëzon dhe ju ndihmon në vitet e para të punës, praktika pedagogjike të cilën e mbajnë studentët gjatë studimeve Bachelor është mjaft dobipurëse. Andaj, qëllimi i këtij punimi është të hulumtoj perceptimet e mësimdhënësve dhe studentëve të Fakultetit të Edukimit, niveli Bachelor, në lidhje me mentorimin dhe praktikën mësimore.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është deskriptive. Në këtë punim janë shfrytëzuar metodat e përziera, qasja sasiore dhe cilësore e hulumtimit. Pjesëmarrës të këtij hulumtimi janë 8 mësimdhënës të shkollave fillore të Prishtinës (mostër e qëllimshme) dhe 150 studentë nga Fakulteti i Edukimit, të cilët kanë mbajtur praktikën mësimore, respektivisht 3 grupe të studentëve: në vitin e dytë, tretë dhe të katërt të studimeve (mostër e rastësishme). Si instrumente për mbledhjen e të dhënave janë shfrytëzuar pyetësorët të përpiluar në bazë të shkallës së Likertit dhe intervista gjysëm të strukturuar. Intervistat janë realizuar me mësimdhënësit e Prishtinës, ndërsa pyetësorët me studentët e Fakultetit të Edukimit. Të dhënat sasiore janë analizuar me programin SPSS, ndërsa të dhënat cilësore me analizë tematike. Rezultatet e fituara nga ky studim tregojnë se mësimdhënësit dhe studentët e konisderojnë mjaft të rëndësishëm mësimin praktik gjatë studimeve. Të dhënat sasiore theksojnë dallime mes studentëve në vite të ndryshme. Ndërsa, analiza tematike na jep këndvështrime të ndryshme të mësimdhënësve për zhvillimin e mësimin praktik, shkathtësitë e studentëve dhe mentorimin në përgjithësi.

**Fjalët kyçe:** *mentorimi, mësimdhënësit, studentët, praktika mësimore, përgatitja pedagogjike.*

---

## **JEHONA DAUTAJ**

**Tema:** "Ndikimi i detyrave të shtëpisë në lëndën e gjuhës shqipe në klasën e parë"

### **Komisioni:**

1. Prof. Naser Pajazit-kryetar,
2. Prof. Adhurim Rasimi-anetar,
3. Prof. Hatixhe Ismajli-mentore

### **ABSTRAKTI**

Ky punim përcakton ndikimin që kanë detyrat e shtëpisë në lëndën e gjuhës shqipe të klasës së parë në suksesin e nxënësve. Detyrat e shtëpisë janë një procedurë e cila përdoret nga mësuesit në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të përgatitur në shkollë. Punimi shërben si dëshmi për rëndësinë e detyrave të shtëpisë, si dhe njëkohësisht krahason ndikimin e detyrave të shtëpisë në raport nga të dhënat demografike nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit.

Metodologjia e hulumtimit është sasiore. Qëllimi i punimit është analizimi i ndikimit të detyrave të shtëpisë në lëndën e gjuhës shqipe në suksesin e nxënësve të klasës së parë. Pyetja themelore në këtë punim është: Çfarë ndikimi kanë detyrat e shtëpisë në lëndën e gjuhës shqipe në ngritjen e suksesit të nxënësve? Popullata e këtij studimi janë mësues, nxënës si dhe prindër. Grupi reprezentativ e përbëjnë dy shkolla nga qyteti i Pejës (shkolla fillore "Asdreni" dhe "Lidhja e Prizrenit"), si dhe dy shkolla nga komuna e Deçanit ("Lidhja e Prizrenit- Deçan dhe "Dëshmorët e Kombit"- Strelc i Ulët). Instrumentet që u përdoren për realizimin e punimit janë: pyetësori për mësues, nxënës dhe prindër. Në hulumtim janë përfshirë 50 nxënës, 25 mësues dhe 25 prindër. Gjithsej 100 respondentë. Rezultatet e hulumtimit tregojnë që detyrat e shtëpisë për nxënësit e klasës së parë janë të rëndësishme pasi ato ndikojnë që ata të jenë më të përgatitur në shkollë, të përvetësojnë me lehtë shkrim-lexim, të jenë më aktiv dhe bashkëpunues në shkollë.

**Fjalët kyçe:** *Detyrat e shtëpisë, lënda e gjuhës shqipe, nxënësit, prindërit, sukcesi i nxënësve.*